



UNHCR
The UN Refugee Agency



Magyar Helsinki Bizottság

Azyl në Hungari 2011

Tani jeni në Republikën e Hungarisë (Magyarország). Gjuha zyrtare është Hungarishtja. Hungaria është shtet anëtar i Bashkimit Europian (BE) dhe ndodhet në Europën Qëndrore - Lindore.



Autoriteti përgjegjës për azyl është **Zyra për Emigracion dhe Shtetësi, ZESH, apo thjeshtë Zyra e Emigracionit** (Bevándorlási és Állampolgársági Hivatal, BÁH), e cila është pjesë e Ministrisë së Punëve të Brendshme.

1. Forma të ndryshme të mbrojtjes që ju mund të merrni në Hungari

• **Statusi i refugjatit (menekült):** Një person i cili ka një frikë të bazuar nga persekutimi në vendin e tij/saj të origjinës për shkak të racës, fesë, kombësisë, mendimit politik, apo anëtarësisë në një “grup të veçantë shoqërorë”.

- “Përsekutim” zakonisht do të thotë shkelje e rëndë e të drejtave të njëriut, të tilla si tortura, trajtimi çnjerëzor ose degradues, sklllevëria, dhuna fizike ose seksuale, apo diskriminimi shumë i rëndë.
- Një “frikë të bazuar” do të thotë se ju mund ta tregoni atë në mënyrë objektive në Zyren e Emigracionit se ju do të ishit viktimë e përsekutimit apo keqtrajtimit, nëse duheshit që të ktheheni në vendin tuaj të origjinës (për shembull: deklaratat tuaja në intervistën për azyl janë koherente dhe të besueshme).
- Nëse keni probleme për arsye se jeni grua, për arsye të identitetit tuaj gjinor apo orjentimit seksual (për shembull ju jeni burrë dhe ndjehesh tërheqës ndaj burrave të tjerë) ose për të patur ndonjë karakteristike tjetër të veçantë që nuk mund të ndryshohet (apo që ju nuk dëshironi ta fshehni), mund të përkisni nën kategorinë e “grupit të veçantë shoqëror”.

• **Statusi mbrojtës plotësues (oltalmazott):** Personi i cili është në rrezik të vërtetë dhe vuan njërin nga dëmet e mëposhtme në vendin e tij/saj të origjinës:

- Dënimi me vdekje;
- Tortura, trajtimi çnjerëzor ose degradues apo ndëshkimi;

Kërcënim serioz për jetën e një civili apo personi për shkak të dhunës së verbër në një konflikt të armatosur por jo për shkak të racës së tij/saj, fesë, kombësisë, opinionit politik apo anëtarësisë në një “grup të veçantë shoqërorë” (për shembull në vendin tuaj ka luftë dhe ju duheshit që të ikni sepse keni jetuar në një zonë lufte edhe në qoftëse nuk keni marrë pjesë në konflikt).

• **Statusi i Toleruar (befogadott):** Statusi mbrojtës bazuar në një rrezik më të përgjithshëm (jo të individualizuar) në vendin e origjinës.

MBANI MEND: Kushtet e këqija ekonomike ose mjedisore në vendin tuaj të origjinës zakonisht nuk ju jep të drejtë për ndonjë nga këto forma të mbrojtjes.

2. Procedura e azylit

? Si mund të kërkoj azyl?

Ju duhet ta dorëzoni kërkesën për azyl sa më shpejt që është e mundur, ose duke e kontaktuar Zyren e Emigracionit ose Policinë (Rendőrség) nëse jeni në burg, në kufi apo në aeroport. Nëse keni arritur në Hungari me dokumente të rreme, ju **menjëherë** duhet ta tregoni këtë, dhe nëse është e mundur tregoni dokumentat e juaja të vërteta; përndryshe kjo mund të ju shkaktojë probleme më vonë në procedurën e azylit. Nuk ka kërkesa formale, ju mund të kërkonit azyl me shkrim apo me gojë në çdo gjuhë.

Nëse keni frikë se polici nuk do të kuptojë kërkesën tuaj për azyl, në mënyrë të qartë thuaje fjalën “MENEKÜLT” (refugjat) apo “MENEDEK” (azyl) në gjuhën Hungareze dhe poashtu paraqitni kërkesën me shkrim në gjuhën tuaj në dy kopje. Ju lutem mos harroni ta nënshkruani kërkesën tuaj!

KUJDES: Nëse keni hyrë në Hungari në mënyrë **ilegale**, autoritetet e emigracionit ndoshta së pari do të fillojnë me **procedurë të deportimit (dëbimit)**. Nëse kjo është kërkesa e juaj e pare për azyl dëbimi i juaj do të pezullohet (kështuqë nuk do të dëboheni derisa Zyra e Emigracionit vendos në kërkesën e juaj për azyl). Nëse tashmë kjo është hera e dytë që bëni kërkesë, procedura për dëbim nuk do të ndalet. Në rast se merrni vendimin për dëbim, ju mund të ankoheni kundër tij brenda **8 ditëve** dhe të kërkonti **pezullimin e dëbimit**. Ju duhet ta paraqitni ankesën me shkrim në Zyrën për Emigracion apo direkt në Polici dhe do ta dërgojnë atë në gjykatën kompetente. Ju mund të kërkonti ndihmë nga një avokat i Komitetit të Helsinkit Hungarez.

? Si procesohet kërkesa?

Procedura e azylit në Hungari ka dy faza. Së pari ekziston një **procedurë e pranueshmërisë** dhe nëse Zyra e Emigracionit vendosë se kërkesa e juaj është e pranueshme, atëherë ndjekin **procedurat në merita** (ekzaminimi në detaje).

A. “PROCEDURA E PRANUESHMËRISË” (előzetes vizsgálati eljárás)

Ju do të keni një **intervistë** me zyrtarin për azyl dhe përkthyesin, zakonisht brenda pak ditëve pas mbërritjes suaj. Ju do të pyeteni lidhur me të dhënat tuaja personale, se si keni ardhur në Hungari dhe arsytet se përse po kërkonti mbrojtje. Mos harroni të përmend nëse keni ndonjë anëtar të familjes tuaj që jeton në Evropë, problemet tuaja shëndetësore dhe nëse keni përjetuar probleme serioze në ndonjë shtet të Evropës gjatë rrugës për në Hungari.

Autoritetet së pari do të shqyrtojnë nëse vini përmes një vendi ku “rregullorja e Dablinit” është përdorur (shih listen e vendeve të Dablinit në faqen 11). Nëse keni kaluar, atëherë “procedurat e Dablinit” do të fillojë në rastin tuaj dhe procedura e pranueshmërisë do të pezullohet derisa procedura e Dablinit ka mbaruar. **Shih faqen 11 për më shumë detaje mbi procedurën e Dablinit.**

Më tej, kërkesa e juaj nuk do të pranohet në “procedurën me meritë” (shqyrtimi në detaje), dhe do të refuzohet, nëse:

- Jeni qytetar i ndonjë shteti anëtarë i Bashkimit Evropian (BE);
- Tashmë jeni njohur si refugjat nga ndonjë shtet anëtar tjetër i BE-së, ose nga ndonjë shtet tjetër dhe ky status ende është i vlefshëm dhe se ju mund të shkoni përsëri në atë vend;
- Keni aplikuar përsëri për azyl pasi të jeni refuzuar në procedurën e azylit të mëparshëm në Hungari, dhe kërkesa juaj e re nuk përmban ndonjë element të ri;
- Keni qëndruar apo udhëtuar përmes një “vendi të tretë të sigurtë” (nga një vend jashtë BE-së) para se të vini në Hungari dhe keni patur mundësinë që të kërkonti azyl atje;
- Keni të afërm në një “vend të tretë të sigurtë” dhe se mund të hyni ligjërisht në atë shtet;

- Një “vend i tretë i sigurtë” kërkon ekstradimin tuaj (për shembull nëse keni kryer ndonjë krim atje);
- Arsyet e juaja për të kërkuar azyl nuk kanë ndonjë lidhje me azyl (për shembull problemi yt i vetëm është se ju nuk mund të gjeni ndonjë punë të paguar mire në vendin tuaj);
- Zyra e Emigracionit nuk mund të përcaktojë nga cili vend keni ardhur, sepse ju nuk jeni duke e thënë të vërtetën;
- Keni pritur shumë gjatë para se të kërkonte azyl, edhe pse keni patur mundësinë ta bëni këtë.

Procedura e Pranueshmërisë zgjatë **30 ditë** më së shumeti. Në rastet e Dablinit kjo mund të zgjatë më gjatë. Nëse aplikoni për azyl në aeroport, Zyra e Emigracionit ka për ta përfunduar procedurën e pranueshmërisë brenda **8 ditëve**.

Procedura e pranueshmërisë do të ndalet dhe mbyllet nëse mungon në intervistë apo nëse zhdukesh!

Nëse Zyra e Emigracionit vendosë se aplikacioni i juaj për azyl është i “papranueshëm” (nuk pranohet), **ju keni të drejtë ankese**. Ju duhet ta dorëzoni ankesën tuaj në Zyrën e Emigracionit brenda 3 dite dhe Zyra do ta përcjellë atë në gjykatën kompetente. Në ankesën tuaj, ju duhet ta spjegoni se përse nuk pajtoheni me vendimin. Gjykata mund të vendosë të ju intervistojë. Afati i fundit për Gjykatën për ta marrë vendimin është **8 ditë**. Megjithatë, në praktikë kjo mund të merrë më shumë kohë. Ju mund ta pyesni avokatin e Komitetit të Helsinkit Hungarez që të ju ndihmojë ta shkruani ankesën tuaj.

? Cilat vende konsiderohen nga Zyra e Emigracionit të jetë vend i “tretë i sigurtë”?

Çdo vend ku:

- Jeta dhe liria jote nuk janë në rrezik për shkak të racës, fesë, kombësisë, mendimit politik apo anëtarësisë në një “grup të veçantë social” ([shih faqen 3](#)) dhe se nuk jeni të ekspozuar ndaj ndonjë rezikut serioz ([shih faqe 3](#));
- Ata nuk do të ju dërgojnë në ndonjë vend tjetër ku ju mund ti nënshtroheni dënimit me vdekje, torturës, mizorisë, trajtimit çnjerëzor dhe degradues apo ndëshkimit; dhe
- Ju mund të aplikoni për statusin e refugjatit dhe të merrni mbrojtjen.

Nëse nuk pajtoheni se një “vend i tretë i sigurt” është aktualisht i sigurtë për juve, ju duhet ta dëshmoni këtë në ankesën e lartë – përmendur.

? Ku do të qëndrojnë gjatë procedurës së pranueshmërisë?

Ose në kampin e hapur të refugjatëve në Debrecen ose në ndonjë burg të emigracionit (nëse keni marrë ndonjë urdhër dëbimi).

- Nëse gjendeni në aeroport dhe Zyra e Emigracionit nuk merr vendim brenda 8 ditësh, ju do të transferoheni në kampin e refugjatëve në Debrecen ose në burgun për emigracion.
- Nëse jeni i mitur (nën moshën 18 vjeçare) dhe nuk keni asnjë anëtar të rritur të familjes për tu kujdesur për juve në Hungari, ju do të dërgoheni në shtëpinë e fëmijëve në Fót. MBANI MEND: Nëse nuk keni ndonjë dokument që të dëshmoni se jeni i mitur dhe autoritetet nuk ju besojnë, ju duhet të kërkonte ekzaminim (kontrollim) special nga mjeku, i cili zyrtarisht mund të thotë nëse jeni më i vogël apo më i madh se 18 vjeçar. Kërko ndihmë nga një avokat i Komitetit të Helsinkit Hungarez.

B. "PROCEDURA NË MERITA" (részletes eljárás)

Gjatë procedurës në-merita, Zyra e Emigracionit do të ju **intervistoj** juve së paku një herë (por ndoshta më shumë herë). Gjatë këtyre intervistave do të ju kerkohet që të shpjegoni në detaje arsyet **pse ju është dashur ta lini vendin tuaj të origjinës**. Intervista juaj e parë e detajuar zakonisht mbahet disa javë pas fillimit të procedurës në-merita. Ju duhet të pyesni avokatin e Komitetit të Helsinkit Hungarez për ndihmë para intervistës tuaj të parë.

"Kredibiliteti juaj" luan një rol shumë të rëndësishëm në këtë procedurë, kështu që është shumë e rëndësishme që ju të jepni një shpjegim të detajuar gjatë intervistës (ave) se përse është dashur ta lëni vendin tuaj. Mundohuni të përqendrohuni në problemet që keni patur në shtëpi si dhe gjërat të cilat jeni friguar në vendin tuaj. Sigurohuni që të mos thoni gjëra kontradiktore gjatë intervistës suaj.

Nëse nuk ju kujtohet ndonjë emër, vend apo datë, mos bëni panikë dhe mos shpikni detaje të pavërteta. Vetëm përpiguni të mendoni për tregimin tuaj gjithnjë dhe jepni sa më shumë informata që është e mundur dhe shpjegoni zyrtarit tuaj pse është vështirë të ju kujtohen detaje të tilla. Nuk është e detyrueshme që të paraqitni ndonjë **dëshmi dokumentuese** (çertifikata, gjykime, artikuj, fotografi, etj.) për ta mbështetur kërkesën tuaj për azyl. Por nëse i keni këto me vete, ato mund të ju ndihmojnë të tregoni se atë që po e thuani është e vërtetë. Në të njëjtën kohë, paraqitja e dokumenteve të rrejtshme mund të ju çojë drejt një procedure kriminale.

Një **shënim i shkruar** do të përgatitet në gjuhën Hungareze gjatë intervistës. Dokumenti duhet të përmbajë të gjitha elementet e rëndësishme të asaj që keni thënë gjatë intervistës. Në fund të intervistës, ky shënim i shkruar do të lexohet dhe përkthehet para juve. **Kur ta nënshkruani intervistën e shkruar, ju gjithashtu nënshkruani se pajtoheni me atë që është shkruar në të.** Kjo do të thotë se do të jetë e pamundur që pastaj të pretendoni se ka pas keqkuptime apo diçka ishte përkthyer në mënyrë jo korrekte. Kështu që dëgjoni me vëmendje kur shënimet lexohen për ju në fund të intervistës. **Ju menjëherë duhet ta thoni nëse ka probleme me përkthimin.**

Në shumicën e rasteve, është shumë vështirë të flitet për arsyet e ikjes nga atdheu i juaj. Por nëse nuk tregoni problemet reale gjatë intervistës suaj, autoritetet nuk do të kuptojë se keni nevojë për mbrojtje. Nëse ndjeheni të lodhur gjatë intervistës, gjithmonë mund të kërkonit për një pushim të shkurtër. Ju poashtu mund të kërkonit ndihmë nga ndonjë mjek apo psikolog nga **Fondacioni Cordelia** (shih informatat kontaktuese në fund të broshurës) se si të flisni me zyrtarin për gjërat e dhimbëshme të cilat nuk do të doni ti kujtoni.

Mbani në mend se zyrtari, përkthyesi, avokati juaj, punëtori social dhe gjykatësi të gjithë kanë një obligim të rrept që të mbajnë të fshëhur çdo gjë që keni thënë. Ata nuk do të tregojnë asgjë për juve tek autoritetet e vendit tuaj (as faktin se keni aplikuar për azyl).

Pas intervistës me zyrtarin e azylit, është e mundur se **shërbimet e sigurisë kombëtare** Hungareze poashtu do të ju intervistoj juve.

Afati për procedurën në-merita është 45 ditë pune, por kjo mund të shtyhet edhe për 22 ditë të tjera. Zyra e Emigracionit zakonisht merrë vendim prej **45 deri 90 ditë**.

? **Ku do të qëndroj gjatë procedurës në-merita (duke përfshirë procedurën e ankesës)?**

- Nëse keni qenë të arrestuar gjatë procedurës së pranueshmërisë, ju mund të mbeten në burg gjatë procedurës në merita poashtu (për më së shumeti 12 muaj).
- Nëse nuk ishit të arrestuar ju do të mund të qëndroni në kampin e refugjatëve në Debrecen. Nëse doni të largoheni për më shumë se 24 orë ju mund të merrni leje nga administrata e kampit. Nëse largoheni nga kampi pa marrë leje për më shumë se 24 orë, Zyra e Emigracionit do të mendojë se jeni zhdukur dhe do ta mbyll procedurën tuaj për azyl.
- Ju poashtu mund të organizoni vetë akomodimin/banimin tuaj privat. Së pari duhet të kërkoni nga Zyra e Emigracionit që të ju lejojë qëndrimin tuaj në banesë private. Për ta bërë këtë, ju duhet ta paraqitni kopjen e çertifikatës që dëshmon se kush është pronar i banesës (tulajdoni lap), plus marrëveshtjen e qirasë (lakásbérleti szerződés) ose një deklaratë nga pronari që dëshmon se ai/ajo ju strehon juve falas (befogadó nyilatkozat).
- Nëse jeni i mitur (nën moshën 18 vjeçare) dhe ju jeni në Hungari pa ndonjë anëtar të rritur të familjes, ju do të qëndroni në shtëpinë e Fëmijëve në Fót. Shih informatat kontaktuese në fund të broshurës.

Mbani në mend nëse vendosni të qëndroni në ndonjë banesë private ju duhet të jeni në dispozicion në adresen që ju i jepni Zyrës së Emigracionit. Sigurohuni se emri juaj është shkruar qartë në të dyjat, derën dhe kutinë postare të shtëpisë. Nëse nuk i merrni letrat që ju dërgon Zyra e Emigracionit, ata do të mendojnë se jeni zhdukur dhe do të mbyllin procedurën tuaj të azylit.

? **Si do ta di se kur dhe ku mbahet intervista?**

Një letër zyrtare të shkruar në gjuhën Hungareze, do të ju jepet juve me të gjitha detajet lidhur me intervistën. Nëse qëndroni në kampin e Debrecenit, zyra e emigracionit do të ju kontaktojë që të ju informojë për datën e intervistës. Nëse qëndroni në banesë private, postieri do të ju sjellë një letër nga Zyra e Emigracionit. Nëse nuk jeni në shtëpi ai/ajo do të ju lë vetëm një njoftim për juve, dhe ju duhet ta merrni letrën zyrtare në postën më të afërt. Nëse keni avokat, Zyra e Emigracionit poashtu do ta njoftojë avokatin tuaj për datën e intervistës. Nëse jeni në paraburgim, zyrtari do të vjen në qendrën e paraburgimit dhe ju do ta keni një intervistë atje.

3. Të drejtat e azilkërkuesve

Gjatë tërë procedurës së azylit:

- Ju mund të përdorni **gjuhën amëtare** apo ndonjë gjuhë tjetër të cilën e flisni mirë (ju keni të drejtën e një përkthyesi).
- Ju mund të kërkoni një përkthyes dhe një zyrtar për azyl **nga e njëjta gjini** si ju (burrë ose grua).
- Ju do të pranoni një **kopje të shkruar** në gjuhën Hungareze e të gjitha vendimeve të marra gjatë procedurës suaj të azylit.

- Ju do të informoheni për **përmajtjen e vendim-it (eve)** në gjuhën tuaj amëtare apo në ndonjë gjuhë tjetër të cilën e kuptoni mirë (me ndihmën e një përkthyesi).
- Ju mund të merrni **ndihmë ligjore falas** nga një avokat dhe/ose nga një organizatë joqeveritare.
- Ju mund ta kontaktoni zyrën e **Komisionit të Lartë për Refugjatë të Kombeve të Bashkuara** (UNHCR) në Budapest (shih informatat kontaktuese në fund të broshurës).
- Kur kërkesa e juaj e azylit arrin te procedura në merita, dhe nëse nuk jeni në paraburgim (burg), ju do të merrni një **leje qëndrimi humanitar**.
- Nëse është procedura juaj e parë dhe nuk jeni paraburgosur, dhe nuk po qëndroni në një banesë private, keni të drejtë të merrni një shumë të vogël mujore **“para të xhepit”** (kur kërkesa juaj e azylit arrin tek procedura në merita).
- Ju keni të drejtën e **kujdesit primarë mjekësor** dhe asistencës urgjente mjekësore. Mjekët vizitojnë kampin e refugjatëve dhe qendrat e paraburgimit disa here në javë.
- Ju mund të **punoni** vetëm nëse jeni duke qëndruar në kampin e refugjatëve dhe **vetëm brenda kampit**. Për më shumë informata kontaktoni administratën e kampit. Nëse procedura e azylit zgjatë më shumë se një vit, keni të drejtë të punoni jashtë kampit. Për këtë, së pari duhet të merrni lejen valide të punës (munkavállalási engedély). Kontakto punonjësin social të Zyrës së Emigracionit ose Shoqatën Menedék për ndihmë (shih informatat kontaktuese në fund të broshurës).
- Fëmijët tuaj kanë të drejtë **shkollimi**. Nëse ata janë të pranishëm në vend për më pak se një vit, ata mund ta ndjekin shkollimin nëse ju e kërkonin këtë.

Siguroheni se ju dhe përkthyesi e kuptoni njëri tjetrin pa vështirësi. Përkthyesit duhet të sillen në mënyrë neutrale. Ata nuk kanë të drejtë të ju shtrojnë pyetjet gjatë intervistës ose dhe se ata nuk duhet të përipiqen të ju bindin që ta tërhiqni kërkesën tuaj të azylit apo ta ndërroni tregimin. Nëse keni vështirësi komunikimi me përkthyesin apo mendoni se përkthyesi nuk është neutral, tregoni këtë problem menjëhere tek zyrtari dhe/ose avokati juaj dhe kërkonin tjetër përkthyes.

4. Rezultatet e mundëshme të procedurës së azylit

Ju duhet të jeni prezent personalisht kur të ju jepet vendimi. Përkthyesi do të ju ndihmojë që ta kuptoni vendimin. Nëse e lëshoni vendin para se të ju është dhënë vendimi, vendimi do të publikohet në tabelën e njoftimeve në Zyrën e Emigracionit dhe pas 8 ditëve ata do ta konsiderojnë sikur të ju është dhënë personalisht. Kjo është e rëndësishme në rast se vendimi është negativ dhe ju ktheheni në Hungari vetëm pasi të ketë skaduar afati i ankesës. Në këtë rast do të duhet të filloni një procedurë të re të azylit dhe të paraqitni dëshmi të reja.

A. Nëse ju jepet mbrojtja

Në ligjin Hungarez ekzistojnë 3 stative mbrojtës. Kur zyrtari i azylit ju tregon për vendimin, ai/ajo do të ju shpjegojnë llojin e statusit mbrojtës që ju është dhënë.

Statusi i refugjatit (menekült)

Ky status është i vlefshëm për një **periudhë të pacaktuar kohore** (por mund të ju mirret në rrethana të veçanta). Nën këtë status ju merrni kartën Hungareze të identitetit për 10 vite, dokumentin e udhëtimit të refugjatit, ju keni të drejtën e punës dhe të bashkimit familjarë. Ju mund të bashkoheni vetem me bashkëshortin tuaj, fëmijët, prindërit (nëse jeni fëmijë pa familje në Hungari) përndryshe vetëm me prindërit të varur ekonomikisht apo anëtarë të afërm të familjes që nuk mund të kujdesen për vetëveten për shkak të arsyeve shëndetësore. Nëse filloni bashkimin familjarë brenda 6 muajve pasi ta keni merrni statusin, ju nuk duhet të tregoni dëshmi se mund ta mbështetni familjen tuaj ose që ata do të kenë sigurim shëndetësorë në Hungari. Pas 3 viteve të qëndrimit të vazhdueshëm në Hungari ju mund të aplikoni për shtetësi Hungareze, por ju duheni që të përmbusheni shumë kushte të ndryshme për ta marrë atë.

Statusi mbrojtës plotësues (oltalmazott)

Ky status është i vlefshëm për **5 vitë**, por mund të tërhiqet më herët nga autoritetet. Ky status mund të përtrihet pas një procesi shqyrtues. Nëse doni të bashkoheni me familje, ju duhet të dëshmoni se jeni në gjendje të mbështetni ata dhe se do të kenë sigurimin shëndetësor në Hungari. Ju mund të aplikoni për shtetësi Hungareze vetëm pas 8 viteve. Shumica e të drejtave tjera janë të ngjajshme me të drejtat e refugjatit.

Statusi i toleruar (befogadott)

Ky status është i vlefshëm për **1 vit**, por gjithashtu mund të tërhiqet më herët nga autoritetet. Ky status mund të përtrihet pas një procesi shqyrtues. Nën këtë status ju merrni leje qëndrimin humanitar, por NUK merr dokument udhëtimit dhe ju mund të punoni vetëm nëse merrni lejen e punës. Nëse doni të bashkoheni me familjen tuaj, duheni të dëshmoni se jeni të aftë për të mbështetur ata dhe se ata do të kenë sigurimin shëndetësor në Hungari. Pas 3 vjetësh ju mund të aplikoni për qëndrim të përhershëm në Hungari.

B. Nëse kërkesa e juaj për azyl refuzohet apo nuk pajtoheni me statusin e dhënë

Ju duhet të paraqitni ankesë në Zyrën e Emigracionit **brenda 15 ditëve** pas marrjes së vendimit. Në ankesën tuaj, ju duhet të shpjegoni pse mendoni se vendimi është i gabuar. Ju mund të pyesni avokatit e Komitetit të Helsinkit Hungarez të ju ndihmojë me ankesën tuaj. Afati i fundit për të vendosur gjykata është 45 ditë pune, por në praktikë procedura mund të marrë **disa muaj**. Gjykata është e detyruar të ju **intervistoj** personalisht.

Në fund të procedurës së ankesës gjykata mund të merr 3 vendime të ndryshme:

- Të pranojë ankesën tuaj dhe të ju jep njërin nga statutet mbrojtës (statusin e refugjatit, statusin mbrojtës plotësues apo statusin tolerues).
- Të pranojë pjesërisht ankesën dhe të anulojë vendimin e Zyrës së Emigracionit, dhe ta urdhërojë Zyrën për të kryer një procedurë të re dhe të ri-shqyrtojë rastin tënd.
- Ta refuzojë ankesën dhe ta pranojë vendimin ashtu siç është.

Vendimi i gjykatës do të jetë përfundimtarë dhe nuk mund të ankoheni kundër tij.

Ju mund të filloni një procedurë të re për azyl, por vetëm në qoftë se mund të paraqitni **fakte të reja ose rrethanat** që nuk u morën parasyesh në procedurën e mëparshme të azylit (për shembull situata në vendin tuaj të origjinës apo situata juaj personale ka ndryshuar që nga proceduara juaj e mëparëshme e azylit). MBANI MEND: Kërkesa juaj e dytë për azyl mund të mos i ndal autoritetet që të ju dëbojnë nga Hungaria para se të përfundojë procedura për azyl. **Në rast se merrni ndonjë urdhër dëbimi, ju duhet të ankoheni kundër tij dhe kërkonte nga gjykata që ta pezullojë dëbimin tuaj në të njejtën kohë.**

C. Kthimi

Nëse merrni një vendimin negative përfundimtarë ju do të keni një intervistë tjetër me Zyren e Emigracionit (këtë herë jo me një zyrtar të azylit, por me një "polic të huaj" zyrtar), në mënyrë që të lëshoj një **urdhër dëbimi**. Gjatë kësaj interviste sigurohuni që të përmendni ndonjë rrethanë të veçantë që mund ti pengojë autoritetet në lëshimin e urdhër dëbimit (për shembull ju keni anëtarë të familjes duke jetuar në Hungari). Nëse urdhër dëbimi është lëshuar, ju do të keni më së shumeti **30 ditë** që ta lëshoni vendin. Ju mund ta apeloni urdhër dëbimin brenda **8 ditëve** duke e dërguar ankesën tuaj në Zyrën e Emigracionit. Gjykykata ka **15 ditë** për të vendosur. Nëse urdhër dëbimi është lëshuar para se të kërkonte azyl, ju nuk mund të ankoheni kundër tij dhe duhet ta lëshoni vendin.

Më lëshimin e urdhër dëbimin ju zakonisht merrni një **ndalesë për hyrje** në zonën Shengen (zonë kjo që përfshin shumicën e shteteve të BE-së). Ndalesa për hyrje mund të urdhërohet për një kohëzgjatje maksimale për **3 vjetësh**, dhe mund të zgjatet më së shumeti nga 3 vjet shtesë në një kohë.

Nëse doni të kthehuni vullnetarisht, ju duhet ta përmendni këtë në intervistë. Ju poashtu mund ta kontaktoni **Organizatën Ndërkombëtare për Migrim** (shih informatat kontaktuese në fund të broshurës), dhe ata do të ju ndihmojnë ta organizoni kthimin vullnetarë. Zyra e Emigracionit poashtu mund të vendosë që ju të ktheheni me dhunë. Në atë rast mund të ju mbajnë në paraburgim, derisa ata ta përgatisin dëbimin tuaj. Urdhër dëbimi mund të pezullohet; nëse nevojitet më shumë kohë për përgatitjen e dëbimit tuaj, koha maksimale arrestimit tuaj është **12 muaj**.

Nëse, për arsye objektive, kthimi juaj është i pamundur, Zyra e Emigracionit do të ju japë një **vërtetim për qëndrim të përkohshme** (ideiglenes tartózkodásra jogosító igazolás), e cila është e vlefshme deri në 3 muaj. Ky vërtetim ju mbron juve nga arresti dhe paraburgimi nëse ndaleni nga policia dhe nuk keni kryer ndonjë vepër apo krim. Me këtë kartë qëndrimi të përkohshëm ju keni të drejtë në kujdesin shëndetësor emergjent. Ky status nuk ju jep të drejtën e punës, të merrni pjesë në arsimin publik apo të merrni ndihmë financiare.

? Ku do të qëndroj gjatë procedurës së kthimit?

Ju do të qëndroni në një burg të emigracionit ose në strehimoren e komuniteteve në Balassagyarmat (shih informatat kontaktuese në fund të broshurës).

5. “Procedura e dablinit” në Hungari

Ju nuk mund të zgjidhni vendin në të cilin ju dëshironi të aplikoni për azyl.

Sipas “Rregullorës së Dablinit” të BE-së, **ju mund të aplikoni për statusin e refugjatis vetëm në një shtet anëtarë të BE-së. Zakonisht, ky është shteti i parë anëtarë që keni arritur. Kjo natyrisht do të thotë se çdo shtet tjetër ku ju aplikoni më vonë do të ju kthejë në shtetin e parë.**

Kjo mund të ndodh kur:

- Shenjat e gishtave janë marrë në ndonjë vend (shenjat tuaja të gishtave janë ruajtur në bazën e përbashkët të të dhënave Evropiane EURODAC, kështu që autoritetet do të ju njohin juve edhe në qoftëse përdorëni emër tjetër apo identitet tjetër).
- Ju i tregoni autoriteteve se keni qenë apo udhëtuar përmes vendit të BE-së, edhe nëse nuk i keni japë shenjat e gishtërinjëve.
- Disa dëshmi të tjera tregojnë se keni qenë në një vend tjetër të BE-së.
- Ju keni një vizë për vendin e BE-së.
- Ju i tregoni autoriteteve se doni të ju bashkoheni bashkëshortit (es), i/e cili/a është azyl kërkues apo refugjat në një vend tjetër.

Rregullorja e Dablinit zbatohet në vendet në vijim: Austri, Belgjikë, Bullgari, Qipro, Republikën Çeke, Danimarkë, Estoni, Finlandë, Francë, Gjermani, Greqi, Hungari, Islandë, Irlandë, Itali, Latvi, Lituani, Luksemburg, Maltë, Holandë, Norvegji, Poloni, Portugali, Rumani, Sllovakia, Slloveni, Spanjë, Suedi, Zvicër dhe Britani të Madhe. Islanda, Norvegjia dhe Zvicra nuk janë antarë të BE-së por prapë marrin pjesë në sistemin e Dablinit.

? Çfarë ndodh nëse Hungaria dëshiron të më dërgojë në një shtet tjetër në bazë të Rregullorës së Dablinit?

Në procedurën e pranueshmërisë (**shih faqen 4**) Zyra e Emigracionit së pari do të shqyrtojë nëse duhet të fillojë procedurën e Dablinit në rastin tënd. Nëse po, procedura e pranueshmërisë pezullohet deri në vendimin se **cili vend është përgjegjës për trajtimin e kërkesës tuaj për azyl**. Procedura e Dablinit mund të marrë një kohë të gjatë, disa javë apo madje muaj. Pasi Zyra e Emigracionit të lëshon vendimin e Dablinit, ju më nuk mund ta tërhiqni kërkesën tuaj për azyl. Nëse Zyra për Emigracion vendosë se një vend tjetër duhet të merret me kërkesën tuaj për azyl, dhe ju nuk pajtoheni me këtë, **mund të ankoheni kundër këtij vendimi**. Ju duhët ta paraqitni ankesën tuaj në Zyrën e Emigracionit **brenda 3 ditëve**. Ankesa juaj do të vendoset nga një gjykatë regjionale, varësisht nga vendi i akomodimit, apo paraburgimit. Ankesa nuk do ta ndalojë automatikisht transferin tuaj. Prandaj, në ankesën tuaj ju poashtu duhet ti **kërkoni gjykatës ta pezullojë transferin tuaj**. Afati zyrtarë për gjykatën që të vendosë është **8 ditë**, por në praktikë kjo mund të zgjasë më shumë. Gjykata nuk do t’ju intervistoj juve personalisht dhe ka shumë pak mundësi që ankesa juaj të jetë e suksesshme. Ju mund të kërkoni ndihmë nga Komiteti i Helsinkit Hungarez.

? **Ku do të qëndroj gjatë procedurës së Dablnit?**

- Ose në kampin e refugjatëve në Debrecen (ju mund ta lëshoni kampin në rastet shumë speciale, nëse autoriteti ju lejon) ose në burgun e imigrimit.
- Nëse jeni i mitur (nën moshën 18 vjeçare) dhe nuk keni ndonjë anëtar të madh të familjës që të kujdeset për juve në Hungari, ju do të dërgoheni në shtëpinë e fëmijëve në Fót. MBANI MEND: Nëse nuk keni ndonjë dokument të dëshmoni se jeni i mitur dhe autoritetet nuk ju besojnë, ju duhet të pyesni për ekzaminin special nga mjeku, i cili zyrtarisht mund të thotë se nëse jeni më i ri apo më i moshuar se 18 vjeç. Kërko ndihmë nga një avokat i Komitetit të Helsinkit Hungarez.

? **A mund të transferohem në ndonjë shtet tjetër nëse jam i sëmurë?**

Ju duhet ti tregoni zyrtarit për azyl për ndonjë paaftësi, probleme shëndetësore apo psikologjike në intervistën tuaj të parë. Nëse Zyra e Emigracionit prapë vendosë të ju dërgojë në një shtet tjetër, ju mund ti përsërisni këto arsye në ankesë kundër vendimit të Zyrës.

? **Anëtari i familjës ime jeton në një shtet tjetër të BE-së. A mund ky vend të bëhet përgjegjës për kërkesën time për azyl.**

Vetëm nëse anëtari i familjes suaj është nën moshën 18 vjeçare, burri, gruaja ose prindërit tuaj (nëse jeni nën moshën 18 vjeçare). Në rast të anëtarëve të tjerë të familjes, ju duhet të dëshmoni se ata varën nga ju për shkak të gjendjes së tyre shëndetsore. Përmende këtë në intervistën tuaj të parë menjëherë pas arritjes suaj.

? **Kam përjetuar problem serioze në vendin e BE-së të cilin e kam kaluar para ardhjes në Hungari. Çfarë mund të bëjë që ta shmangi transferimin tim në këtë vend?**

Ju duhet ta përmendeni këtë në intervistën tuaj të parë me Zyrën e Emigracionit. Nëse Zyra ende vendosë që të ju dërgojë në këtë shtet, ju mund të përsërisni këto arsye në ankesë kundër vendimit të Zyrës. Mos harro të kërkonti nga gjykatat që ta pezullojë transferin tuaj.

? **Tash më kam kërkuar azyl në një vend tjetër të BE-së dhe kërkesa ime për azyl ishte refuzuar. Pse autoritetet Hungareze përsëri duan të më kthehin në këtë vend të BE-së?**

Procedura e Dablnit do të fillojë edhe në qoftë së kërkesa juaj ishte refuzuar, përveç nëse vendi nga i cili keni marrë vendimin negativ ka filluar procedurën e dëbimit.

Kërkoni për azyl apo për ta ruajtur kërkesën tuaj të mëparëshme të azylit, ju duheni që **ta bëni këtë të qartë në intervistën tuaj të parë me Zyrën e Emigracionit**. Praktika në Hungari është se Zyra e Emigracionit së pari fillon **procedurën e dëbimit (deportimit)**, e cila mund të rezultojë në një urdhër dëbimi dhe vetëm pastaj kërkesa juaj për azyl do të shqyrtohet. Nëse kjo është hera e parë që kërkonti azyl, dëbimi juaj do të pezullohet, por nëse është hera e dytë atëherë nuk do ta parandaloj dëbimin tuaj. Në rastë se merrni vendimin e dëbimit, duhet të ankoheni kundër tij brenda **8 ditësh** dhe poashtu të kërkonti për pezullimin e deportimit nëse është i

rëndësishëm. Ju duhet ta dorëzoni kërkesën në Zyrën e emigracionit ose drejt në Polici dhe ata do ta dërgojnë atë tek gjykata përkatëse. Ju mund të kërkonti ndihmë nga ndonjë avokat i Komitetit të Helsinkit Hungarez.

A. Nëse keni aplikuar për azyl në Hungari më parë dhe procedura juaj ka përfunduar

? Kur përfondon procedura ime?

- Nëse merrni vendimin negative përfundimtarë (aplikacioni juaj dhe ankesat janë refuzuar),
- Nëse vendimi i parë ishte negative dhe keni humbur afatin për ankesë apo nuk keni shkuar në seancë gjyqësore,
- Nëse e keni lënë Hungarinë dhe procedura e juaj ishte mbyllur (pa ndonjë vendimin mbi kërkesën tuaj).

Nëse ktheheni në Hungari dhe procedura juaj e mëhershme e azylit ka përfunduar, ju duhet të filloni një procedurë të re të azylit. Për tu pranuar procedura juaj e re e azylit, ju duhet të paraqisni **fakte të reja të rëndësishme ose rrethana** të cilat nuk ishin konsideruar në procedurën e mëparëshme të azylit (për shembull, situatë në vendin tuaj të origjinës apo situatë juaj personale ka ndryshuar që nga procedura e kaluar e azylit).

MBANI MEND: Kërkesa e juaj e dytë për azyl nuk i parandalon autoritetet që të ju deportojnë juve nga Hungaria. Nëse rate të tilla (nëse merrni një urdhër dëbimi) **ju duhet të akoheni kundër urdhër dëbimit** dhe poashtu **të kërkonti nga gjykata që ta pezullojë dëbimin tuaj.**

B. Nëse nuk keni aplikuar për azyl në Hungari më parë

Ju mund të aplikoni për azyl kur të jeni transferuar në Hungari. Nëse merrni një urdhër dëbimi, dëbimi do të pezullohet përderisa procedura e azylit të zgjatë, por **ju prapë duhet të bëni ankesë kundër urdhër dëbimit.**

? Ku do të qëndroj kur të kthehem në Hungari?

- Ose në kampin e hapur të refugjatëve në Debrecen ose në ndonjë burg të emigracionit (nëse keni marrë një urdhër dëbimi).
- Nëse jeni i mitur (nën moshën 18 vjeçare) dhe nuk keni anëtarë të rritur të familjes me juve në Hungari, do të ju dërgojnë në shtëpinë e fëmijëve në Fót. **MBANI MEND: Nëse nuk keni ndonjë dokument ta dëshmoni se jeni të mitur dhe autoritetet nuk ju besojnë, ju duhet të kërkonti për një ekzaminim/kontrollim të veçantë nga mjeku, i cili zyrtarisht mund të thotë nëse jeni më i ri ose më i moshuar se 18 vjeç. Kërkonti ndihmë nga një avokat i Komitetit të Helsinkit Hungarez.**

6. Informatat kontaktuese

Komiteti Helsinkit Hungarez (Magyar Helsinki Bizottság) Ndhimë ligjire falas.

Budapest (zyra qendrore), 1054 Budapest, Bajcsy-Zsilinszky út 36–38.

Tel/fax: 06 1 321 4323, 06 1 321 4141, Website: www.helsinki.hu, e-mail: helsinki@helsinki.hu

Gjuhët: Hungarisht, Anglisht, Frengjisht, Spanjollisht, Italisht, Serbisht, Rusisht dhe Gjermanisht.

Ju lutem thirrni për caktimin e terminit!

Burgi për emigracion Békéscsaba / Tímea Kovács, avokat

6720 Szeged, Tisza L. körút 34, tel: 06 20 496 7372

Gjuhët: Hungarisht, Anglisht. Avokati viziton burgun një herë në javë.

Kampi i refugjatëve Debrecen / Orsolya Szántai-Vecsera, avokat

4033 Debrecen, Sámsoni út 149. House No. 47 (shtëpia e gjelbërt), tel/fax: 06 52 448 446.

Gjuhët; Hungarisht, Anglisht, Frengjisht, Serbisht. Konsultimet: E Hëne-Enjete pasdite, E premte paradite.

Shtëpia e Fëmijëve në Fót / Júlia Iván, avokat

Komiteti Helsinkit Hungarez, 1054 Budapest, Bajcsy-Zsilinszky út 36–38, tel/fax: 06 1 321 4323

Gjuhët: Hungarisht, Anglisht, Frengjisht. Ju lutem gjithnjë thirrni për caktimin e terminit!

Aeroporti Ndërkombëtar Budapest Liszt Ferenc, burgi emigracionit / Gábor Győző, avokat

Komiteti i Helsinkit Hungarez, 1054 Budapest, Bajcsy-Zsilinszky út 36-38, Tel/fax: 06 1 321 4323

Gjuhët: Hungarisht, Anglisht. Avokati e viziton aeroportin çdo dy javë.

Burgi emigrantve Nyírbátor / Róbert Miskolczi, avokat

4400 Nyiregyháza, Iskola utca 3, tel: 06 42 506 313

Gjuhët: Hungarisht, Anglisht. Avokati viziton burgun një herë në javë.

Burgu i emigracionit Győr / Norbert Nagy, avokat

9027 Győr, Tátika u. 1. 2/6, tel. 06 70 234 9202

Gjuhët: Hungarisht, Anglisht. Avokati viziton burgun një herë në javë.

Burgu emigracionit Kiskunhalas / Tímea Kovács, avokat

6720 Szeged, Tisza L. körút 34, tel: 06 20 496 7372

Gjuhët: Hungarisht, Anglisht. Avokati viziton burgun një herë në javë.

Shoqata Menedék (Menedék Egyesület)

Ndhimë sociale falas (nëse ju duhet ndihmë për shembull për të gjetur punë, një vend për të fjetur, etj).

Budapest (Zyra qendrore) 1090 Budapest, Erkel utca 13/A, kati #5, tel: 06 1 411 1710, 06 1 411 1711,

06 20 430 9919, fax: 06 1 411 1711, Website: www.menedek.hu, e-mail: menedek@menedek.hu

Gjuhët: Hungarisht, Anglisht, Serbisht. Ju lutem gjithmonë thirrni për caktimin e terminit!

Burgu emigracionit Békéscsaba / Saeed Mohamed Abu Jubere, punëtor social

Vendi: brenda në burg, tel: 06 20 227 4267, gjuhët: Hungarisht, Anglisht, Arabisht.

Kampi refugjatëve Debrecen / Tímea Kovács, punëtor social

Vendi: Shtëpia Nr. 47 (shtëpia e gjelbërt), tel/fax: 06 52 428 537, 06 20 226 7286
Gjuhët: Hungarisht, Anglisht, Rumanisht. Ju lutem gjithmonë thirrni për caktimin e terminit!

Burgu emigracionit Kiskunhalas / Zsuzsa Perák, punëtor social

Vendi: Brenda në burg, tel/fax: 06 77 422 539, 06 20 476 4510

Gjuhët: Hungarisht, Anglisht, Serbisht.

Burgu emigracionit Nyírbátor / Éva Adoba, punëtor social

Vendi: Brenda në burg, tel/fax: 06 42 254 6600, 06 70 331 9568

Gjuhët: Hungarisht, Anglisht, Rusisht, Ukrainisht.

Fondacioni Cordelia (Cordelia Alapítvány)

Ndihmë falas psikologjike, rehabilitim i viktimave të torturës dhe azyl-kërkuesve të traumatizuar.

Budapest (zyra qendrore), 1133 Budapest, Kárpát utca I./B, 6th floor #24.

Tel: 06 1 349 1450, fax: 06 1 239 1332, website: www.cordelia.hu, e-mail: cordelia@chello.hu

Nuk ka konsultime në këtë zyre, por psikiatri viziton kampet e refugjatëve në Debrecen dhe Bicske një here në javë. Ju lutem kërkoni nga punëtori social për kohën e vizites së tyre.

Gjuhët: Hungarisht, Anglisht, Rusisht.

Komisioni i Lartë për Refugjatë i Kombeve të Bashkuara (UNHCR)

UNHCR Përfaqësia Regjionale për Evropën Qendrore, 1022 Budapest, Felvinci utca 27.

Tel: 06 1 3363 060, fax: 06 1 3363 080, Website: www.unhcr-centraleurope.org, e-mail: hunbu@unhcr.org

Organizata Ndërkombëtare për Migracion (IOM)

Ndihma për kthim vullnetarë. 1065 Budapest, Révay utca 12,

tel: 06 1 472 2500, 06 80 205 018 (hotline), fax: 06 1 374 0532

Website: www.iom.hu, e-mail: iombudapest@iom.int

Ndihma ndër-kishtare Hungareze (Magyar Ökumenikus Segélyszervezet)

Shtëpia e Fëmijëve në Fót, Vörösmarty tér 2, tel: 06 30 749 2273

Zyra për Emigracion dhe Shtetësi (Bevándorlási és Állampolgársági Hivatal)

Drejtoria e Azylit, 1117 Budapest, Budafoki út 60, tel: 06 1 463 9170, fax: 06 1 463 9108,

Website: www.bevandorlas.hu, e-mail: menekult@bah.b-m.hu

Kampet e refugjatëve

Strehimorja për integrim Bicske, 2060 Bicske, Csabdi út 20, tel: 06 22 350 907

Shtëpia e Fëmijëve në Fót, 2151 Fót, Vörösmarty Mihály út 4. tel: 06 27 358 490

Kampi i refugjatëve në Debrecen, 4033 Debrecen, Sámsoni út 149, tel/fax: 06 52 413 517

Strehimorja e Komunitetit

Strehimorja e Komunitetit Balassagyarmat, 2660 Balassagyarmat, Kossuth u. 43., tel: 06 35 501 041

Burgjet e emigracionit

Burgu në aeroport, Repülőtéri Rendőrgazgatóság, Budapest, 1675 Budapest, Pf. 10. tel: 06 1 294 1166

Békéscsaba, 5600 Békéscsaba, Kétegyházi út 10, tel: 06 66 519 830, 06 66 452 617

Győr, 9026 Győr Szövetség út 17, tel: 06 96 337 810

Kiskunhalas, 6400 Kiskunhalas, Mártírok útja 25, tel: 06 77 522 944

Nyírbátor, 4300 Nyírbátor, Bocskai út 2-4, tel: 06 42 510 568